



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN
BELEDIYES



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
NJESIA E BURIMEVE NJEREZORE

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik, Nr.08/L-197, neni 80 dhe 81, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 neni 8, Normativet të MASHT Nr.05/2021 dhe Nr. 05/2015, si dhe neni 8 paragrafi 3 pika 3.2 dhe paragrafi 5 te Rregullores (QRK) NR: 19/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzues për DKA -të nga MASHTI 2024, NJMBNJ shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Institucioni: Komuna e Gjilanit

Drejtoria: Komunale e Arsimit

Lloji i pozitës: Shërbimit Publik-mësimdhënës

Numri i pozitave: tre (3) vende

Titulli i mbikëqyrës: Drejtori i Shkollës përkatëse

Paga bazë në muaj: E19, koeficienti 5.6, sipas ligjit për pagat në sektorin publik.

Nr.	Niveli	Institucioni/ Shkolla	Vendi	Titulli i vendit të punës	Vendi i lirë/ Zëvendësim	Koefi enti i pagës
1	SHFM U	SHFMU "Selami Hallaqi"	Gjilan	Gjuhë gjermane	Kohë të caktuar Pushim i lehonisë	5.6
2	SHFM U	SHFMU "Ramiz Cernica" – Cërrnicë "Vebi Ibrahimimi" Uglar	Gjilan	TIK	Kohe e caktuar 31.08.2025	5.6
3	SHFM U	SHFMU "Aferdita" K.Pole "Ramiz Cernica" Gumnishtë	Gjilan	TIK	Kohe e caktuar deri 31.08.2025	5.6

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, Nr. 05/2015, si dhe Rregullorja (QRK) NR: 19/2024, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Udhëzuesin për DKA-të nga MASHTI 2024,

Përshkrim i shkurtër i detyrave punuese:

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktojë ai/ajo.
- Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.
- Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.
- Punët dhe detyrat e tjera të parapara me dokumente, ligje dhe akte të tjera nënligjore në fuqi.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këto vende të punës:

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs

1. Kandidatët e interesuar për të konkurruar për personel edukativo-arsimor duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.3. Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 1.4. Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- 1.5. Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- 1.6. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndëne institucion publik; 16/ 30
- 1.7. Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

2. Përjashtimisht paragrafit 1.1. shtetasit e huaj mund të aplikojnë kur kjo lejohet sipas legjislacionit në fuqi për zyrtarët publik. (të bëjë nostrifikimin e diplomës)

Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

3. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të posedojnë këto dokumente:

- 3.1. Diplomën për përgatitjen arsimore e noterizuar (ose certifikatën e noterizuar në vend të diplomës duhet të jetë jo më e vjetër gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit). Kandidatët të cilët i kanë të përfundua studimet e nivelit master duhet t'i bashkëngjisin edhe diplomën e studimeve themelore.
- 3.2. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- 3.3. Vërtetimin e përvojës së punës në mësimdhënie, nëse aplikuesi ka përvojë pune;
- 3.4. Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit;
- 3.4.1. Përjashtimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet përmbushja e kriterit të parashikuar në paragrafin
- 3.5. Dëshminë për përfundimin e suksesshëm të provimit shtetëror për mësimdhënës/e sipas legjislacionit përkatës për profesionet e rregulluara, nëse një provim i tillë është bërë i detyrueshëm për të ushtruar profesionin e mësimdhënësit/ses përmes një akti tjetër nënligjor të MASHTI;
- 3.6. Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- 3.7. Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre.
- 3.8 Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës).

Vlerësimi i kandidatëve:

Procedura e vlerësimit të konkursit publik përmban gjithsej njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë (50) pikëve nga të gjitha fazat e konkursit publik. Jetë përshkrimi-Portofolio (CV) i kandidatit vlerësohet deri në njëzet (20) pikë, testimi me shkrim deri në pesëdhjetë (50) pikë dhe intervista me gojë deri në tridhjetë (30) pikë.

Informata të përgjithshme :

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 5 ditë nga data: 13.02.2025 deri më: 17.02.2025, ora 16.00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Dokumentacioni dorëzohet në kopje, pasi që i njëjti pas përfundimit të procedurave të rekrutimit nuk kthehet.

Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Qendrën për Shërbime me Qytetarë) ose shkarkohet nga ëeb faja zyrtare e Komunës së Gjilanit <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> dhe e plotësuar dorëzohet në Qendrën për Shërbime me Qytetarë (objekti, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme).

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar shkollimin jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it, nr. 8/2010.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në testim me shkrim. Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% e më shumë të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave, dhe proceseve të tjera, kandidatët do të informohen përmes njoftimit i cili do të publikohet në ueb faqen e Komunës dhe tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit.

Rezultatet e testit me shkrim dhe përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web faqen zyrtare të komunës së Gjilanit <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> dhe në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Menaxher i Burimeve Njerëzore

Burim Kryeziu

